 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:****Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Ekonomia Pyjore	Perdorimi i Territorit	Sipërfaqja (ha)
"Molung"	Trungishte (Klasa I - III e moshës)	352.25
	Cungishte	261.5
	Shkurre, Kullota, livadhe	3,319.77
	Tok me bim.pyj+Inprod+djerr+tjera	434.1

Afatet e ekzekutimit:

Nr.	FAZAT E PLANIT TË MBARËSHTIMIT	MUAJ					
		I	II	III	IV	V	VI
1.	Nënshkrimi i fillimit të punës, vlerësimin e aftësive të stafit BA						
2.	Procesi i konsultimit me palët e interesuara dhe identifikim i qëllimeve dhe objektivave të PMPK						
3.	Puna përgatitore						
3.1	Trajnimi i ekipit						
3.2	Grumbullimi i dokumentave të nevojshme						
3.3	Drafti i hartës pyjore (ndarja parcelare dhe rrjeti sipërfaqeve provë)						
4.	Puna e terrenit (të dhënat bazë)						
4.1	Përgatitja e punës së terrenit						
4.2	Përshkimi parcelar						
4.3	Inventarizimi i pyjeve dhe kullotave						
4.4	Rekomandimet për mbarështimin (objektivat dhe masat)						
5.	Raportimi i të dhënave dhe planifikimi aktiviteteve						
5.1	Përgatitja e Raportit						
5.2	Përgatitja e Hartës						
5.3	Planifikimi vjetor i ndërhyrjeve/aktiviteteve						
5.4	Vlerësimi ekonomik						
6	PMPK dhe SISP						
6.1	Futja, trajnimi, grumbullimi i të dhënave dhe hartave etj.						
6.2	Përshkimi parcelar (të dhëna nga SISP dhe sipërfaqet prove etj.)						
6.3	Ngarkimi i raportit, planifikimi vjetor, hartat etj.						
6.4	Procesi i validimit të PMPK në SISP						
6.5	Miratimi PMPK						

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

PËRMBAJTJA

I. TË PËRGJITHSHME

Plani i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave (më poshtë PMPK) është një dokument bazë për mbarështimin e pyjeve dhe kullotave i hartuar sipas ekonomive kullimore, me punime terreni e zyre, për njohje dhe marrje të dhënash për tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj, si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura të nevojshme silvikulturore.

Planifikimi afatgjatë i qeverisjes së pyjeve dhe kullotave për një periudhë 10 vjeçare duhet të mbulojë të gjitha aspektet sociale, ekologjike dhe ekonomike.

Në kuadër të reformës administrativo-territoriale, Bashkisë Lezhe, me ane të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar, janë transferuar dhe kanë kaluar në pronësi sipërfaqet e fondit pyjor e kullor në territorin e kësaj bashkie.

Më poshtë po japim një përshkrim të shkurtër të ekonomise kullimore që ne propozojmë të kryejmë planin e mbarështimit.

I.1. EKONOMIA PYJORE “MOLUNG”.

Ekonomia pyjore Molung shtrihet në Njësitë Administrative Kosh dhe Zejmen. Në to bëjnë pjesë Fshatrat; Kolsh, Velë, Kaçinar, Patalej, Lalm Lukaj, Grykë-Manati, Manati, Tresh, Spiten, Markatomaj, Zejmen dhe Pllane. Kjo ekonomi shtrihet poshtë vargmaleve Vele-Kodermolung dhe kufizohet me rrugën automobilistike Lezhe-Milot. Karakteristikat kryesore të relievit të kësaj ekonomie është ekzistenca e pasur e një rrjeti të dendur hidrografik me prroska dhe perrenj malor.

Kjo ekonomi pyjore dominohet kryesisht nga lloje të dushqeve si qarri, bunga, ilqja shoqëruar më disa lloje shkurresh si shkoza, thana, frashëri, dëllinja, shqopa, krifsha etj. Në këtë ekonomi pyjore ka sipërfaqe të mbjellura me pishë të egër në mënyrë artificiale. Nënpylli është i pasur me lloje bimësh mjekësore eterovajore e tanifere.

I.2. BURIMI I FINANCIMIT

Bashkia Lezhe me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e planeve të reja të mbarështimit të fondit pyjor, nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.113, datë 15.12.2025 “ Për miratimin e

PBA 2026 -2028 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2026”, ka akorduar fondin për hartimin e studimit dhe planizimit të sipërfaqes pyjore Molung.

II. TERMAT E REFERENCËS PËR HARTIMIN PMPK

Termat e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr.864 prot, datë 30.01.2019.

Manuali përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të plotësojë subjekti i kontraktuar gjatë fazës së punimeve të terrenit dhe ato të përpunimit të dhënave më pas në zyrë.

Keto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për konsulentët që do të hartojnë Planin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave për këtë ekonomi kullimore të Bashkisë Lezhe, bazuar në Udhëzuesin e lartpërmendur.

Kontraktori në realizimin e këtij shërbimi duhet të marrë në konsideratë parshikimet ligjore të fushës dhe produkti final duhet të jetë në përputhje me këto parashikime ligjore.

II.1. DETYRAT QË NDIQEN PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Detyrat që duhet të zbatojë subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave janë:

- Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullimore në ekonominë pyjore.
- Përshkrimi i përgjithshëm në terren i parcelave e n/parcelaveve, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse.
- Vlerësimi i sipërfaqes dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes:
 - Trungishte
 - Cungishte
 - Shkurre
- Vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës.
- Vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta).
- Identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve.
- Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë.
- Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet ekologjike të zonës.
- Eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zonës.
- Hartogrfimi i territorit të zonës (në GIS), duke përfshirë:
 - Ekonominë pyjore, ndarjen e parcelave e të n/parcelave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes/Përdorimin e territorit të zonës.
 - Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve.
 - Rrjetin e përhershëm dhe të përkohshëm të sipërfaqeve provë.
 - Rrjetin rrugor ekzistues dhe rrjetin hidrografik.
 - Marrja e profileve të tokës për çdo tip toke dhe kategori thellësie.
 - Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.
 - Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor të menaxhimit për ekonominë pyjore.
 - Hartimi i strategjive të duhura të menaxhimit, si dhe planit të veprimit.

-
- Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë.
 - Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre.
 - Evidentimi i sipërfaqeve (në ha) të tjetërsuara në ullishte disa vite më parë.

Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të menaxhimit me palët e interesuara.

Konsultimi i draft-planit të menaxhimit me aktorët vendimarrës (Bashkia Lezhë, Ministria e Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, grupet e interesit etj).

Reçensime të draft-planit të përgatitur.

Ripunim materiali pas vërejtjeve të bëra.

II.2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Lezhë (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifikë të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, do të jenë:

Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat.

Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë.

Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunktionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.

Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor.

Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues.

Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues.

Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit.

Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve dhe prerjeve të paligjshme.

Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore.

Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të popullsisë lokale në marrjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave.

Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.

Menaxhimi i punës për hartimin e planit dhe futjen e tij në Sistemin e Informacionit Shqiptar në Pyje (SISP).

II.3. QËLLIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbarështimit të qëndrueshëm që nënkupton se dueht të ruajë dhe të forcojë gjendjen shëndetsore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm.

Ky plan hartohet për ekonominë pyjore “Molung” që është pjesë e Bashkisë Lezhë dhe natyrisht në kordinim edhe me njësitë e tjera ekonomike fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme.

Hartimi i Planit të Mbarështimit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndërveprim me aktorët dhe Bashkinë si dhe kordinim me institucionet qendrore nëpërmjet përdorimit

të Sistemit të Informacionit Shqiptar në Pyje (SISP) dhe kjo duhet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmërisë së planit.

II.4. FAZAT QË NDIQEN PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE

Sipas Udhëzuesit, procesi i hartimit të PMPK duhet të ndjekë këto faza:

- Puna përgatitore
- Puna në terren
- Puna në zyrë

Puna përgatitore

Grumbullimi i të dhënave ekzistuese dhe dokumentave të nevojshme për hartimin e PMPK

Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela

Futja në SISP e planit të ri të mbarështimit dhe menaxhimi i procesit të punës

Organizimi dhe menaxhimi i procesit të pjesmarrjes së aktoreve

Puna në terren dhe përshkrimi parcellar

Vizitat në terren

Përshkrimi parcellar

- Struktura e përshkrimit parcellar
- Të dhënat parcellare dhe lidhja me Kadastrën Pyjore dhe SISP

Hartimi i hartës paraprake dhe ndërtimi i rrjetit të sipërfaqeve provë

Mjetet për punën e terrenit.

Vendosja e shenjave dalluese (sipas Manualit) të kufinjve mes parcelave dhe nënparcelave.

Planifikimi inventarizimit dhe përshkrimi i rrjetit të sipërfaqeve provë

Metoda e inventarizimit dhe kampionimit për matjet e kullotave.

Produktet pyjore jodrusore (bimët aromatiko-mjekësore, frutat pyjore, lulet, farat, shërbimet e ekosistemit etj.)

Futja e të dhënave dhe kontrolli

Të dhënat parcellare dhe lidhja me Kadastrën Pyjore dhe SISP

Puna në zyrë/raportimi

Procesi për hartimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave duhet të respektojë standartet në mënyrë që të përftohen produkte finale homogjene (raporti, të dhënat, hartat etj) me qëllim përpunimin e të dhënave, transferimin e tyre në SISP dhe një koherencë me Inventarin Kombëtar të Pyjeve (IKP).

II.5 PËRMBAJTJA E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE

1. HYRJE

1.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK)

1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

1.3. Metodologjia e Punës

1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË

2.1. Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë pyjore

2.2. Pronësia, administrimi, organizimi

2.3. Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

2.4. Konteksi i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

-
- 2.5. *Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore*
 - 2.6. *Situata demografike dhe social-ekonomike*
 - 2.7. *Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jodrusore*
 - 2.8. *Gjuetia dhe peshkimi*
 - 2.9. *Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike*
 - 2.10. *Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve*

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 3.1. *Mbarështrimi dhe funksionet e Pyjeve dhe Kullotave*
 - 3.1.1. *Përdorimi i territorit (aktual & propozimet)*
 - 3.1.2. *Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)*
 - 3.1.3. *Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela*

4. KUSHTET STACIONALE

- 4.1. *Klima*
- 4.2. *Topografia dhe morfologjia*
- 4.3. *Gjeologjia*
- 4.4. *Tokat*
- 4.5. *Rrjetihidrologjikdheburimet e furnizimit me ujë*
- 4.6. *Erozioni në shpate dhe rrjedhiet ujore*
- 4.7. *Rrëshqitjet*

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

- 5.1. *Brezat bioklimatike*
- 5.2. *Pyjet dhe kullotat*
- 5.3. *Tipet e pyjeve*
- 5.4. *Tipet e kullotave*
- 5.5. *Tipet potenciale të vegjetacionit*
- 5.6. *Biodiversiteti*
- 5.7. *Prania e vlerave konservuese të larta (VKL)*
- 5.8. *Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin*
- 5.9. *Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkim shkencor*

6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 6.1. *Analiza e të dhënave për Pyjet*
 - 6.1.1. *Analiza e tipeve të pyjeve*
 - 6.1.2. *Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas forms së qeverisjes*
 - 6.1.3. *Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit*

Paraqitja në formë tabelare e të dhënave për secilën formë qeverisjeje në lidhje me:

 - sipërfaqen totale kundrejt klasës së moshës*
 - volumin për hektar kundrejt klasës së moshës*
 - sipërfaqen e specieve në raport me klasat e moshës*
 - volumi i specieve kundrejt klasave të moshës*
 - sipërfaqen totale për klasa prodhimi*
 - volumin total për klasa prodhimi*
 - sipërfaqja sipas specieve kundrejt klasave të prodhimit*
 - volumin sipas specieve kundrejt klasave të prodhimit*
- 6.2. *Analiza e të dhënave të kullotave*
 - 6.2.1. *Gjëndja e kullotave*
 - 6.2.2. *Madhësia e sipërfaqes së kullotave dhe vendodhja e tyre*

-
- 6.2.3. *Altituda, pjerrësia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike*
 - 6.2.4. *Mbrritshmëria*
 - 6.2.5 *Grumbullimi i të dhënave për zonat e djegura në kullota (10 vitet e fundit)*

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 7.1 *Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve*
 - 7.1.1. *Analiza statistikore e Inventarizimit*
 - 7.1.2. *Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjorë*
 - 7.1.3. *Struktura Vertikale*
 - 7.1.5. *Cilësia e materialit drusor*
 - 7.1.6. *Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomassës*
 - 7.1.7. *Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e karbonit*
- 7.2. *Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare*
 - 7.2.1. *Drurët e tharë*
 - 7.2.2. *Dëmtimet e tjera*
- 7.3. *Prerjet e paligjshme*
 - 7.3.1 *Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në procesin e planifikimit*
 - 7.3.2. *Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve*
- 7.4 *Rezultatet e Inventarizimit të Kullotave*
 - 7.4.1. *Tipi dhe cilësia e kullotave*
 - 7.4.2. *Përdoruesit e kullotave dhe koha*
 - 7.4.3. *Llojet e bagëtive*
 - 7.4.4. *Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave*
 - 7.4.5. *Infrastruktura aktuale*
 - 7.4.6. *Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me bazë ushqimore*

8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

- 8.1. *Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë*
- 8.2. *Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave*
- 8.3. *Pajtuueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie*
- 8.4. *Objektivat kryesore të PMPK*
- 8.5. *Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM*
 - 8.5.1. *Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/mbarështimit*
 - 8.5.2. *Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve*
 - 8.5.3. *Objektivat specifike silvikulturale*
 - 8.5.4. *Objektivat specifike për kullotat*
 - 8.5.5. *Objektivat specifike mbi biodiversitetin*
 - 8.5.6. *Objektivat specifike mbi gjëndjen shëndetsore*
 - 8.5.7. *Objektivat specifike mbi faunën*
 - 8.5.8. *Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues*
 - 8.5.9. *Objektivat specifike për pyjet me funksion mbrojtës*
 - 8.5.10. *Objektivat specifike për pyjet me funksion rekreacioni*
 - 8.5.11. *Objektivat specifike për pyjet me funksion konservues*

9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PK

- 9.1. *Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit*
- 9.2. *Prerja vjetore silvikulturore*
- 9.3. *Planifikimi vjetor i masave*
 - 9.3.1. *Masat në Pyje*

9.3.2. Masat në kullota

9.3.3. Masat në infrastrukturë dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike

9.4. Masat afat-gjata

9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte

9.4.2. Masat silvikulturore në cungishte

9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre

9.4.4. Pyllëzimi, ripyllëzimi

9.4.5. Masat në kullota

9.4.6. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore

9.4.7. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

9.4.8 Analiza e riskut nga zjarret, identifikimi e hartëzimi i zonave me risk të lartë.

9.4.9 Planifikimi i masave infrastrukturore për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve.

9.4.10 Masat për menaxhimin e vegjetacionit dhe reduktimin e materialit djegës.

9.4.11 Mekanizmat e koordinimit institucional për parandalimin dhe reagimin ndaj zjarreve.

10. VLERËSIMI EKONOMIK

10.1. Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota

10.2 Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve

10.3 Planifikimi i kostove/shpenzimeve

10.4 Analiza kosto-përfitim

II.6. PËRGATITJA E HARTAVE

Me rëndësinë që kanë hartat tematike në procesin e planifikimit është e nevojshme që të përcaktohen:

Tematika e hartave në përshtatje me kushtet e reja të territorit

Elementet grafike standart, ngjyrat dhe emërtesat

Dixhitalizimi i hartave dhe integrimi i tyre në sistemin GIS

Hartat që do të përgatiten nga kontraktori në kuadër të planit të mbarështimit duhet të jenë të dixhitalizuara, të gjeoreferuara, me të gjitha elementët identifikues (kuota, rrjeti rrugor, rrjeti hidrik, emërtesat e vendeve, kufijtë e zonave të mbrojtura, izoipset kryesore etj) në shkallën 1:10 000 dhe 1:25 000. Hartat duhet të prodhohen nëpërmjet platformës së informacionit SISP.

Inventarizimi i grumbujve dhe metoda e punës për hartimin e Planit të Mbarështimit do të bazohet në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Plani i Mbarështimit i hartuar nga kontraktori së bashku me hartat pyjore dhe dokumentacioni shoqërues do të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor në 5 kopje të printuara dhe 5 kopje në format elektronik (CD). Cilësia e materialeve që do të përdoren për printimin e planit të mbarështimit dhe hartave duhet të jetë e kategorisë cilësore (letër format double A). Hartat do të vishen me material plastik rezistues ndaj ujit.

Hartat duhet të realizohen në sistemin GIS dhe ato që do të përgatiten janë:

Harta e Ekonomisë Pyjore me izohipse, kuota dhe emrat e fshatrave

Harta e Funksioneve

Harta e tipeve të pyjeve, shkurreve dhe kullotave

Harta e rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe sipërfaqeve të degraduara

Harta e ndërhyrjeve

III. AFATI I HARTIMIT TË PLANEVE TË MBARËSHTIMIT

Për realizimin e hartimit të Planit të Mbarështimit për këtë ekonomi kullimore parashikohet një afat kohor 6 muor që fillon me nënshkrimin e kontratës me subjektin e kontraktuar deri në procesin final të dorëzimit të raportit përfundimtar.

Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme për arritjen e këtij qëllimi deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar.

Fazat që ndiqen për hartimin e Planit të Mbarështimit dhe afatet përkatëse, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

IV. GRAFIKU I REALIZIMIT TË PLANIT TE MBARËSHTRIMIT

Nr.	FAZAT E PLANIT TË MBARËSHTRIMIT	MUAJ					
		I	II	III	IV	V	VI
1.	Nënshkrimi i fillimit të punës, vlerësimin e aftësive të stafit BA						
2.	Procesi i konsultimit me palët e interesuara dhe identifikim i qëllimeve dhe objektivave të PMPK						
3.	Puna përgatitore						
3.1	Trajnimi i ekipit						
3.2	Grumbullimi i dokumentave të nevojshme						
3.3	Drafti i hartës pyjore (ndarja parcelare dhe rrjeti sipërfaqeve provë)						
4.	Puna e terrenit (të dhënat bazë)						
4.1	Përgatitja e punës së terrenit						
4.2	Përshkrimi parcelar						
4.3	Inventarizimi i pyjeve dhe kullotave						
4.4	Rekomandimet për mbarështimin (objektivat dhe masat)						
5.	Raportimi i të dhënave dhe planifikimi aktiviteteve						
5.1	Përgatitja e Raportit						
5.2	Përgatitja e Hartës						
5.3	Planifikimi vjetor i ndërhyrjeve/aktiviteteve						
5.4	Vlerësimi ekonomik						
6	PMPK dhe SISP						
6.1	Futja, trajnimi, grumbullimi i të dhënave dhe hartave etj.						
6.2	Përshkrimi parcelar (të dhëna nga SISP dhe sipërfaqet prove etj.)						
6.3	Ngarkimi i raportit, planifikimi vjetor, hartat etj.						
6.4	Procesi i validimit të PMPK në SISP						
6.5	Miratimi PMPK						

V. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTRIMIT

Autoriteti kontraktor do të monitorojë fazat e ndryshme të hartimit të Planit të Mbarështimit dhe punimet që realizohen nga subjekti kontraktor.

Personi/at përgjegjes për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të caktuar nga Bashkia Lezhë do të monitorojnë procesin e hartimit të Planit të Mbarështimit nga subjekti i kontraktuar në lidhje me:

Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në përgjithësi.

Përmbushjen e kërkesave dhe kriterëve teknike të manualit të mbarështimit të pyjeve në fuqi për punimet e terrenit dhe ato të zyrës.

Respektimin e kriterëve tekniko-ligjore nga kontraktori gjatë procesit të hartimit të Planit të Mbarështimit.

Zbatimin e afateve kohore për realizimin e fazave dhe aktiviteteve nga kontraktori të përcaktuara paraprakisht.

Detyrime të tjera të kontraktorit.

Personi/at përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të caktuar nga Bashkia Lezhë gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, njofton me shkrim titullarin zyrtar, në lidhje me problematikat që konstaton gjatë procesit të hartimit të Planit të Mbarështimit si dhe sugjeron masat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe tekniko-ligjore nga ana e kontraktorit.

Personi/at përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës në përfundim të çdo faze harton raportin e monitorimit.

Personi/at përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës të caktuar nga Bashkia Lezhë bën dhe reçensimin e Draft Planit të Mbarështimit pasi është paraqitur nga kontraktori dhe ja paraqet organeve për miratim sipas ligjit. Për çdo kërkesë apo mosmiratim nga autoritetet përkatëse përfaqësuesit e AK-se njoftojnë kontraktorin i cili është përgjegjës për përshtatjen e planit me dispozitat ligjore të fushës në fuqi dhe është përgjegjës për miratimin.

VI. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Draft Plani i Mbarështimit të ekonomisë kullimore i hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët lokal (Nj. Administrative, shoqatat e pyjeve, komuniteti lokal, grupet e interesit etj) dhe reçensimit, merr në shqyrtim dhe reflekton të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e bera nga aktoret e sipërpërmendur. Draft plani i Mbarështimit të ekonomisë kullimore me ndryshimet dhe reflektimet e bëra pas reçensimit i kalon për miratim strukturave të përcaktuara sipas akteve ligjore në fuqi.

Kontraktori ndjek me përgjegjësi të gjitha fazat e hartimit të planit dhe është përgjegjës për miratimin e tij në institucionet përkatëse.

Produkti final duhet të jetë në përputhje me parashikimet ligjore të fushës dhe kontraktori është përgjegjës për çdo arsye mos miratimi nga institucionet vendore apo qendrore.

VII. REFERENCA LIGJORE

Gjatë hartimit të këtij projekti janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e menaxhimit të pyjeve dhe në fushën e prokurimit publik.

Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

Ligji Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”;

Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 433, datë 08.06.2016 për “Transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 361, datë 12.05.2010, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullor publik”;

Manualin e Mbarështimit të Integruar të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019;

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë e kritereve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta te kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se operatori ekonomik i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të

kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë te punësuar mesatarisht të paktën 8 (tete) punonjës për periudhën Qershor 2026 - Gusht 2026.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimit.

2.3.3 Ofertuesi duhet të disponojë në stafin kryesor, punonjesit si më poshtë:

- I. 1 (një) Inxhinier Pyjesh Drejtues teknik i pajisur me diplome universitare dhe me "Çertifikate profesionale", për shërbime profesionale për projekte sipas germës (c) pika 1 neni nr. 3, e Rregullores nr. 3, datë 08.07.2009, "Për çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota"

Për të përmbushur këto kriter duhet të paraqitet Diploma, Certifikata Profesionale dhe Kontrata e punës, si dhe të figurojnë në Listë pagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2026 - Gusht 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat përkatëse.

- II. 2 (dy) Specialistë Pyjesh Inxhinier të pajisur me diplome universitare dhe me "Çertifikate profesionale", për shërbime profesionale për projekte sipas germës (c) pika 1 neni nr. 3, e Rregullores nr. 3, datë 08.07.2009, "Për çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota"

